

**VENDIM**  
**Nr. 279, datë 25.9.2023**

**MBI MIRATIMIN E KONTRATËS NDËRMJET SHOQËRIVE KESH SHA DHE  
FTL SHA, PËR SHITJEN/BLERJEN/DEPOZITIMIN/SHKËMBIMIN E ENERGJISË  
ELEKTRIKE PËR PERIUdhËN KOHORE 1.1.2023–31.12.2023**

Në zbatim të neneve 16, 20, germa “h”, si dhe 90, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 105, germa “c”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pjesës I, nenit 5, pikës 7, të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456, datë 29.6.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; të VKM-së nr. 650, datë 10.10.2022, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 584, datë 8.10.2021, të Këshillit të Ministrave, Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”; të VKM-së nr. 449, datë 26.7.2023, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 584, datë 8.10.2021, të Këshillit të Ministrave, Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.9.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1957/1 prot., datë 8.9.2023, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike, “Mbi miratimin e kontratës ndërmjet shoqërive KESH sh.a. dhe FTL sh.a. për shitjen/blerjen/depozitimin/ shkëmbimin e energjisë elektrike” dhe informacionin shtesë me nr. 1957/3 prot., datë 22.9.2023, “Mbi miratimin e kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, KESH sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve që furnizohen nga FSHU sh.a.” dhe “Mbi miratimin e kontratës ndërmjet shoqërisë KESH sh.a. dhe shoqërisë FTL sh.a. për shitjen/blerjen/depozitimin/shkëmbimin e energjisë elektrike.”,

konstatoi se:

- Shoqëritë KESH sh.a. dhe FTL sh.a., me shkresën nr. 1957 prot., datë 24.7.2023, dërguan në ERE kontratën e lidhur ndërmjet KESH sh.a. dhe FTL sh.a. për depozitimin, shkëmbimin dhe shitblerjen e energjisë elektrike për vitin 2023, me nr. 3177 prot., datë 29.6.2023, të KESH sh.a. dhe nr. 1908/1 prot., datë 30.6.2023 të FTL sh.a.

- ERE, në zbatim të neneve 6 dhe 12, të “Rregullores mbi procedurat e njoftimit dhe konsultimit publik të akteve të miratuara nga Enti Rregullator i Energjisë”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 162, datë 20.10.2020, më datë 25.7.2023, publikoi kontratën e sjellë për miratim në faqen zyrtare të internetit të saj për komente apo objeksione nga palët e treta, dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët, nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Kontrata e protokolluar në ERE me shkresën nr. 1957 prot., datë 24.7.2023, me lëndë: “Dërgohet për miratim kontrata e lidhur ndërmjet KESH sh.a. dhe FTL sh.a. për depozitimin, shkëmbimin dhe shitblerjen e energjisë elektrike për vitin 2023” është sjellë në zbatim të nenit 5, pikës 7, të VKM-së nr. 456, datë 29.6.2022, dhe përbëhet nga 10 nene.

- Konstatohet se në kontratën e sjellë në ERE për miratim nuk referohen si bazë ligjore aktet e mëposhtme ligjore të cilat duhet të shtohen:

- Vendimi nr. 23, datë 25.3.2009, i Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë, “Mbi rinovimin e licencave në aktivitetin e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike shoqërisë KESH sh.a.”, i ndryshuar;

- Vendimi nr. 122, datë 4.4.2023, i Bordit të Entit Rregullator të Energjisë, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë ‘Furnizuesi i Tregut të Lirë’ sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”;

- Vendimi nr. 327, datë 14.12.2022, i Bordit të ERE-s, “Mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2023”;

- Vendimi nr. 27, datë 16.2.2023, i Bordit të ERE-s, “Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2023, në zbatim të ndryshimeve të miratuara me VKM-në nr. 67, datë 8.2.2023”.

- Në parakushtin e tretë të kontratës shkruhet se: “Është shpallur gjendja e emergjencës në furnizimin me energji elektrike përgjatë të gjithë vitit 2022 deri më 30 qershor 2023” sqarojmë se: VKM-ja nr. 584, datë 8.10.2021, “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës për furnizimin me energji elektrike”, e ndryshuar me VKM-në nr. 650, datë 10.10.2022, e shtyn gjendjen e emergjencës në furnizimin me energji elektrike deri më 30 qershor 2023 dhe VKM-në nr. 449, datë 26.7.2023, e shtyn gjendjen e emergjencës në furnizimin me energji elektrike deri më 31 dhjetor 2023. Për sa më sipër, bazuar në ndryshimet e fundit të VKM-së nr. 584, datë 8.10.2021, të ndryshuar me VKM-në nr. 449, datë 26.7.2023, parakushti i fundit i kontratës të shkruhet “Është shpallur gjendja e emergjencës në furnizimin me energji elektrike përgjatë gjithë vitit 2022 deri më 31 dhjetor 2023”.

- Për sa i përket parashtrimit të katërt të kontratës vlerësojmë se duhet të ndryshohet pasi VKM-ja nr. 456, datë 29.6.2022, në pikën 3 specifikon se: “ ... ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.”, dhe VKM-ja nr. 456/2022, ka hyrë në fuqi që më datë 1.7.2022, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 98. Për sa sqaruar, parakushti i 4 i kontratës “Deri në hyrjen në fuqi të vendimit nr. 456, datë 29.6.2022, të Këshillit të Ministrave, detyrimi për shërbim publik vendosur për shoqëritë e sektorit dhe marrëdhënie mes shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal rregulloheshin nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 620, datë 22.10.2021, i ndryshuar.”, të ndryshohet si vijon: “Detyrimi për shërbim publik vendosur për shoqëritë e sektorit dhe marrëdhënies mes Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal rregullohen nga vendimi nr. 456, datë 29.6.2022, i Këshillit të Ministrave”.

- Në nenin 3, pika 1, “Realizimi i transaksioneve” në fund të paragrafit është shtuar “në kuptim të parashikimeve të nenit 5, pika ,7 të VKM-së nr. 456/2022” ky përcaktim është konform VKM-së nr. 456/2022.

- Neni 4, “Çmimi, faturimi dhe pagesa”, në kontratën e sjellë për miratim në ERE me nr. 1957 prot., datë 24.7.2023, në ndryshim nga kontrata e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 337/2022, është shtuar neni 1 me përmbajtje: “Çmimi i shitjes dhe i blerjes së energjisë elektrike që do të zbatohet në këtë kontratë është ai i miratuar nga ERE për energjinë e prodhuar nga prodhuesit me përparësi hidrike” kjo shtesë vlerësohet e drejtë sepse është në zbatim të akteve ligjore në fuqi, përkatësisht ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, si dhe VKM-së nr. 67, datë 8.2.2023, ‘Për një ndryshim në vendimin nr. 687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi’, të ndryshuar”.

- Rakordimi i faturës tatimore lidhur me tepricat nga prodhimi i energjisë në këtë kontratë është rënë dakord që të bëhet brenda 10 ditëve pas përfundimit të periudhës 6-mujore, në kontratën e miratuar me vendimin nr. 337/2022, rakordimi ka qenë në fund të vitit kalendarik. Palët kanë rakorduar një periudhë rakordimi më të shkurtër se 12 muaj për të realizuar rakordimet ndërmjet tyre, e cila vlerësohet e arsyeshme sepse i jep palëve mundësi që të kenë një vlerësim më të shpejtë për detyrimet e lindura ndërmjet tyre.

- Gjithashtu, është shtuar pika 5, në nenin 4, me përmbajtje: “Pagesa e faturës e lëshuar sipas rakordimit të pikës 3 të këtij neni, nga pala blerëse, realizohet brenda datës 30 të muajit janar të vitit pasardhës pasi palët me marrëveshje, kanë rakorduar dhe shuar me kompensim (netim) detyrimet reciproke që kanë realizuar përgjatë vitit.”.

Kontrata ka një efekt nga 1 janari deri në 31 dhjetor dhe rakordimi final bëhet për të gjithë sasi të lëvruara për këtë periudhë dhe për rrjedhojë pagesa realizohet deri në fund të muajit janar të vitit që vjen.

- Në kontratën e sjellë në ERE për miratim është shtuar neni 8 “Parashikime kalimtare” me përmbajtje: “1. Palët, bazuar në parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 456, datë 29.6.2022, rakordojnë sasi të energjisë elektrike të depozituara/shkëmbyera përgjatë vitit kalendarik, sipas të dhënave faktike të periudhës së rakordimit. 2. Ky rakordim mbyllet jo më vonë se data 25.1.2024.”.

Ky nen është konform përcaktimeve të nenit 4, pikat 3 dhe 5, “Çmimi, faturimi dhe pagesa”, për sa përcaktuar dhe në nenin 4, palët rakordojnë brenda 10 ditëve pas përfundimit të periudhës 6-mujore dhe lëshimi i faturës realizohet brenda datës 30 të muajit janar të vitit pasardhës. Vlerësohet i drejtë shtimi i këtij neni me përmbajtjen e sipërcituar.

- Neni 9 i kontratës së sjellë për miratim në ERE trajton hyrjen në fuqi. Në pikën 1 shkruhet se: “Kjo kontratë dhe secili nga kushtet këtu do të hyjë në fuqi pas miratimit nga ERE”, vlerësojmë që kjo fjalë të plotësohet si vijon: “Kjo kontratë dhe secili nga kushtet këtu do të hyjë në fuqi pas miratimit nga ERE dhe do t’i shtrijë efektet nga data 1.1.2023–31.12.2023”.

- Në kontratën e sjellë për miratim në ERE me shkresën nr. 1957 prot., datë 24.7.2023, nuk përfshihet më aneksi 1 i kontratës, me përmbajtje akt rakordimet për energjinë elektrike të depozituar dhe shkëmbyer midis palëve të cilat qenë pjesë e kontratës së miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 337/2022 dhe duhet të shtohet si pjesë integrale e kontratës së sjellë për miratim në ERE me shkresën nr. 1957 prot., datë 24.7.2023.

- Në nenin 105, germa “c”, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” citohet se: “c) organi kompetent mund t’i japë fuqi prapavepruese aktit kur kjo lejohet nga ligji dhe është në favor të palëve të interesuara, dhe nuk dëmton të drejtat e një pale të tretë, duke argumentuar se kjo është një marrëdhënie dypalëshe ndërmjet KESH sh.a. dhe FTL sh.a., që duhet të rregullohet me kontratë, në zbatim të nenit 5, pikës 7, të VKM-së nr. 456, datë 29.6.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, dhe nuk dëmton palë të tretë, vlerësohet që kontrata e sjellë për miratim në ERE, me shkresën e protokolluar me të tonën me nr. 1957 prot., datë 24.7.2023, të miratohet nga ERE me ndryshimet e përcaktuara në konstatime për periudhën 1.1.2023–31.12.2023.”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Miratimin me ndryshimet përkatëse sipas konstatimeve në këtë vendim, në bazën ligjore, në parakushtin e tretë dhe të katërt, si dhe në aneksin 1 të kontratës ndërmjet shoqërisë KESH sh.a. dhe shoqërisë FTL sh.a., për shitjen/blerjen/depozitim/shkëmbimin e energjisë elektrike për periudhën kohore 1.1.2023–31.12.2023 (bashkëlidhur).

1.1 Në bazën ligjore të shtohen aktet e mëposhtme:

- Vendimi nr. 23, datë 25.3.2009, i Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë, “Mbi rinovimin e licencave në aktivitetin e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike shoqërisë KESH sh.a.”, i ndryshuar;

- Vendimi nr. 122, datë 4.4.2023, i Bordit të Entit Rregullator të Energjisë “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë ‘Furnizuesi i Tregut të Lirë’ sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”;

- Vendimi nr. 327, datë 14.12.2022, i Bordit të ERE-s, “Mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2023”;

- Vendimi nr. 27, datë 16.2.2023, i Bordit të ERE-s, “Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2023, në zbatim të ndryshimeve të miratuara me VKM-në nr. 67, datë 8.2.2023”.

1.2 Parakushti i tretë i kontratës është: “Është shpallur gjendja e emergjencës në furnizimin me energji elektrike përgjatë gjithë vitit 2022 deri më 30 qershor 2023”.

Ndryshon dhe bëhet: “Është shpallur gjendja e emergjencës në furnizimin me energji elektrike përgjatë gjithë vitit 2022 deri më 31 dhjetor 2023”.

1.3 Parakushti i katërt i kontratës është “Deri në hyrjen në fuqi të vendimit nr. 456, datë 29.6.2022, të Këshillit të Ministrave, detyrimi për shërbim publik vendosur për shoqëritë e sektorit dhe marrëdhënie mes Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal rregulloheshin nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 620, datë 22.10.2021, i ndryshuar.”, ndryshon dhe bëhet: “Detyrimi për shërbim publik vendosur për shoqëritë e sektorit dhe marrëdhënies mes Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal rregullohen nga vendimi nr. 456, datë 29.6.2022, i Këshillit të Ministrave”.

1.4 Të shtohet aneksi 1 i Kontratës me përmbajtje akt rakordimet për energjinë elektrike të depozituar dhe shkëmbyer midis palëve.

2. Kontrata e nënshkruar nga palët me ndryshimet sipas pikës 1 në këtë vendim, të dërgohet në ERE brenda 5 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

3. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqëritë KESH sh.a., FTL sh.a. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
**Petrit Ahmeti**